



Planuar / Doretuar Punëpunë/Produktuar Regjistruar/Delivered	13 - 07 - 2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Hr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKRIMSHICK	4080/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.528/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit AA.Nr.503/2021 të datës 31.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.535/2018 të datës 17.08.2018 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në kundër Vendimit me numër KA.Nr.49/2018 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike " *masë disiplinore-ndërprerje e marrëdhënies së punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.535/2018 e datës 17.08.2018 e parashtruar nga ankuesit
- II. **Anulohet** Vendimi me numër KA.nr.49/2018 i datës 17.07.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimi me numër KD.nr.02/2018 i datës 08.06.2018 i Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe **çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje** të Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- III. **Obligohet** Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës/Prokuroria Themelore në Gjakovë më datë 17.08.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4753/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.Nr. 49/2018 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të Rregullores, me propozimin që Këshilli të prish vendimin e atakuar dhe ankuesin ta kthejë në vendin e punës Zyrtar Ligjor.

Kolegji i Këshillit duke vepruar sipas ankesës së ankuesit të datës 17.07.2018 me Vendimin me numër A.nr.535/2018 të datës 15.10.2018, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën me numër A.nr.535/2018 të datës 17.08.2018 duke shfuqizuar Vendimin KA.Nr.49/2018 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimin me numër KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit i pa kënaqur me vendimin e Këshillit ka parashtruar kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit me numër A.Nr.535/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktvendimin A.nr. 2527/2018 të datës 29.10.2018 ka aprovuar si të bazuar kërkesën e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Këshillit të Pavarura Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.535/2018 të datës 15.10.2018 deri ne marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, duke vepruar sipas padisë së paditësit-Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 14.04.2021 nxjerrë Aktgjykimin A.nr.2527/2018, me të cilin refuzohet kërkesë padia e paditësit Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe e vërteton vendimin me numër A.nr.535/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli Prokurorial i Kosovës i pa kënaqur me Aktgjykimin Anr.2527/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 18.05.2021 parashtron ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrativ, e cila me Aktgjykimin me numër AA.nr.503/2021 të datës 31.05.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën e Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 18.05.2021 si dhe anulon Aktgjykimin A.Nr.2527/2018 të datës 14.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative si dhe Vendimin me numër A.nr.535/2018 të datës 15.10.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështja i kthehet organit të paditur në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4753/2018 të datës 17.08.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi KD.Nr.02/2018 i datës 08.06.2018 i Komisionit Disiplinor; Akt Emërimi i datës 08.10.2015 i ankuesit; Libri i Pranimit i datës 17.07.2018; Libri i Pranimit i datës 11.06.2018; Procesverbali i datës 17.06.2018 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali i datës 07.06.2018 mbi marrje në pyetje të Ankesa e ankuesit e datës 22.06.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të

Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesa e datës 07.06.2018 për inicim të procedurës disiplinore nga Aktakuza me numër PP.nr.932/2017 të datës 07.09.2017; Raport i datës 08.05.2018 me numër PP.Nr.932/2017; Thirrje e datës 06.06.2018 për paraqitje para Komisionit Disiplinor për ankuesin; Vendimi KD.Nr.01/2018 i datës 30.03.2018 i Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesa e datës 17.05.2018 për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit nga Administratorja e Prokurorisë Themelore në Gjakovë; Aktvendimi PP/II.Nr.1066-7/18 i datës 25.05.2018 nga Prokuroria Themelore në Prizren për Fillimin e Hetimeve; Deklarata e datës 05.04.2018 e Avokatit

e-mail i datës 14.05.2018 nga Ali Selimaj për Lavdim Krasniqin; Aktvendimi me numër P.Nr.866/19 i datës 27.02.2020 i Gjykatës Themelore Prizren/Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal; Aktvendimi P.Nr.577/19 i datës 20.09.2021 i Gjykatës Themelore Prizren/Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal; Aktvendimi PN.Nr.376/2020 i datës 21.07.2020 i Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti i Përgjithshëm; Aktvendimi PN.Nr.1068/2021 i datës 22.03.2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti i Përgjithshëm; Aktgjykimi A.nr.2527/2018 i datës 05.05.2021 i datës 31.05.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi AA.nr.503/2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke vepruar sipas Aktgjykimit AA.Nr.503/2021 të datës 31.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative, dhe pasi ka rishqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar që lënda të kthehet në rishqyrtim pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale, rezulton se ankuesi sipas Akt-it të emërimit të datës me Nr. protokollit ZBNJ/DP-48/2015 të datës 08.10.2015, është emëruar në pozitën " Zyrtar Ligjor" në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Me tutje nga vlerësimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se Administratorja në Prokurorinë Themelore në Gjakovë përmes kërkesës me numër protokollit 850 të datës 17.05.2018, ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit në pozitën e Zyrtarit Ligjor me pretendimin së i njëjti përkundër masës disiplinore të pezullimit në mënyrë të vazhdueshme me sjelljet e tij ka penguar disa persona të kësaj prokurorie, duke shpifua dhe imagjinuar fjalë dhe të pavërteta lidhur me këta persona, dhe së këto shpifje janë prezentuar edhe në kallëzimin penal PPN.Nr.35/2018 të datës 12.03.2018 të ushtruar nga ankuesi ndaj prokurores Kryeprokurorit dhe Prokuroritt dhe se ndaj ankuesit lidhur me incizimet dhe fotografitë e bëra në mënyrë të paautorizuar i është ngritur kallëzim penal me datë 13.04.2018 në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me Vendimin KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore duke shqiptuar masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës, pa i dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension". sipas nenit 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi kundër vendimit të Komisionit Disiplinor ka ushtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës i cili më Vendimin KA.nr.49/2018 i datës 17.07.2018 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke lenë në fuqi Vendimin KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor. Me tej ankuesi me datë 17.08.2018 parashtron ankesë kundër Vendimit KA.nr.49/2018 i datës 17.07.2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të Rregullores, me propozimin që Këshilli të prish vendimin e atakuar dhe ankuesin ta kthej në vendin e punës Zyrtar Ligjor.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit me numër KA.nr.49/2018 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimin me numër KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 i Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 64 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj*, si dhe nenin 65 paragrafi 1 dhe 3 ku është përcaktuar se: *1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji. 3. Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore*, dhe si rrjedhojë Kolegji në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe nga vlerësimi i Vendimit KD.nr.02/2018 i datës 08.06.2018 ka gjetur se Komisioni Disiplinor ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas nenit 6 paragrafi 1 paragrafi 1.15 dhe 1.19 të Rregullores Nr.04/2011 për procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil si dhe nenit 4 paragrafi 1 nen paragrafi 1.5 dhe 1.7, nenin 5 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Po nga shtjellimi i pronave materiale lidhur me këtë çështje, Kolegji vëren se lidhur me pretendimin ankimor të inicuesës së procedurës disiplinore ndaj ankuesit se: *për shkak të incizimeve dhe fotografimit në mënyrë të paautorizuar iu është ngritur kallëzimi penal me datë 13.04.2018 në Prokurorinë Themelore në Prizren, Gjykata Themelore në Prizren/Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal me Aktvendimin P.Nr.866/19 të datës 19.02.2020 ka hudhë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren/Departamenti i Përgjithshëm PP/II Nr.371-9/19 të datës 08.07.2019 duke pushuar procedurën penale kundër të pandehurit ne këtë rast ankuesit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par. 3 të KPRK-së i vërtetuar me Aktvendimin PN.Nr.376/2020 të datës 21.07.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës.*

Kolegji nisur nga gjendja faktike dhe juridike si me lart, konstaton së Komisioni Disiplinore me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe së ka bërë konstatim të përgjithësuar të shkeljeve disiplinore pa u mbështetur në prova dhe fakte konkrete, dhe si rrjedhojë i terë konstatimi mbi përgjegjësinë disiplinore të ankuesit bazohet vetëm në deklaratat e Administratores së Prokurorisë Themelore në Gjakovë avokatit Prokurorit si dhe Kryeprokurorit rrjedhimisht mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor ka përgjegjësinë ligjore që me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore të veproj në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 71 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më të cilin është përcaktuar se: *1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar*, ndërlidhur me këtë Kolegji vlerëson gjatë vërtetimit të shkeljeve disiplinore duhet të merret parsh

dhe fakti se masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me shkeljen e kryer si dhe dëmin e shkaktuar me veprimin disiplinor të nëpunësit civil ashtu siç përcaktohet me nenin 66 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civilë ku thuhet: *Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor'.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, me Vendimin me numër KA.nr.49/2018 të datës 17.07.2018 nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar dispozita material me rastin e refuzimit të ankesës së parashtruar kundër vendimit të Komisionit Disiplinor, Andaj mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, në riprocedurë duhet të eliminoj shkeljet e konstatuar sipas këtij vendimi, dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.528/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Procesmbajtëse



Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

